



Monitorimi i Reformave dhe Planit të Rritjes të Ballkanit Perëndimor

Donatori:
Komisioni Evropian

Kohëzgjatja:
01.12.2024 - 01.12.2027

Qëllimi kryesor i kësaj nisme është t'u mundësojë organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve) në Ballkanin Perëndimor (BP) të kontribuojnë në mënyrë aktive në hartimin dhe zbatimin e reformave që lidhen me katër shtyllat e Planit të Rritjes për BP-në.



Grupet e synuara

- ✓ OShC-të në BP që punojnë në fushat prioritare të Planit të Rritjes;
- ✓ Partnerët socialë dhe dhomat e tregtisë;
- ✓ Autoritetet kombëtare, institucionet rajonale dhe ato të BE-së, përgjegjëse dhe të përfshira në zbatimin e Planit të Rritjes;
- ✓ Mediat nga Ballkani Perëndimor dhe Bashkimi Evropian.

Përfituesit fundorë

- ✓ Shoqëria civile në BP;
- ✓ Institucionet kombëtare dhe vendore në BP;
- ✓ Parlamentet kombëtare;
- ✓ Delegacionet e BE-së dhe përfaqësuesit e shteteve anëtare;
- ✓ Akademia;
- ✓ Qytetarët dhe sipërmarrjet në BP.

Objektivat specifike të nismës janë:

SO1.

Krijimi dhe aplikimi i instrumentave të bazuar në të dhëna dhe të udhëhequr nga OShC-të për monitorimin e reformave ekonomike të lidhura me procesin e integritetit dhe projektet infrastrukturore strategjike të financuara nga BE-ja.

Rezultatet e pritshme

- ✓ O1.1. Metodologji dhe mjete hulumtimi të përgatitura për monitorimin e zbatimit të Planit të Rritjes dhe Agjendave të Reformave të BP;
- ✓ O1.2. Gjashtë raporte kombëtare dhe një raport rajonal për zbatimin e Agjendave të Reformave;
- ✓ O1.3. Përditësime mbi Agjendat e Reformave kombëtare duke paraqitur nivelin e zbatimit të reformave në fushat prioritare;
- ✓ O1.4. Gjashtë raporte kombëtare dhe një raport rajonal mbi zbatimin e investimeve strategjike të mbështetura nga Western Balkans Investment Framework (WBIF);
- ✓ O1.5. Gjashtë materiale kombëtare dhe një rajonal me përditësime për projektet e mbështetura nga WBIF;
- ✓ O1.6. Një raport rajonal mbi "Mekanizmin e kushtëzimit të BE-së në Planin e Rritjes për BP-në";
- ✓ O1.7. Faqe interneti për Monitorimin e Planit të Rritjes dhe Reformave.

SO2.

Ndërtimi i dialogut shumëpalësh të udhëhequr nga OShC-të për zbatimin e reformave strukturore në nivel kombëtar dhe rajonal.

- ✓ O2.1. Memorandume Bashkëpunimi me institucionet koordinuese të Agjendave të Reformave në të paktën katër shtete;
- ✓ O2.2. Mekanizma konsultimi shumëpalëshe të krijuara, mbështetura dhe promovuara në nivel kombëtar për Planin e Rritjes;
- ✓ O2.3. Përfundime të nxjerra nga takimet konsultuese dhe dialogu ndërmjet qeverive dhe OShC-ve;
- ✓ O2.4. Gjetje dhe rekomandime mbi zbatimin e Planit të Rritjes të përfutuara nga konsultimet në nivel kombëtar dhe rajonal;
- ✓ O2.5. Institucione zbatuese dhe politikëbërës të informuar mbi mangësitë e identifikuara gjatë zbatimit të Planit të Rritjes përmes advokimit;
- ✓ O2.6. Konferencë Rajonale mbi Planin e Rritjes për BP-në;
- ✓ O2.7. Identifikim dhe promovim i praktikave të mira mbi ndërveprimin e qeverisë dhe OShC-ve për reformat ekonomike nëpërmjet përgatitjes dhe publikimit të udhëzuesve për përfshirje në reformat ekonomike që lidhen me BE-në.

SO3.

Forcimi i kapaciteteve dhe përfshirja e OShC-ve në hartimin dhe zbatimin e reformave sektoriale përmes një skeme rigrantimi.

- ✓ O3.1. OShC-të mbështeten për t'u përfshirë në hartimin dhe përzgjedhjen e reformave sektoriale nëpërmjet skemës së rigrantimit "Re-form for Growth";
- ✓ O3.2. OShC-të trajnohen për menaxhim projektsh dhe mentorohen për planifikim dhe zbatim fushatash advokuese në nivel kombëtar dhe evropian;
- ✓ O3.3. Shkëmbim informacionesh dhe përvojash mes OShC-ve që punojnë në fushat që lidhen me 4 shtyllat e Planit të Rritjes nëpërmjet eventeve online për rrjetëzim.

SO4.

Rritja e ndërgjegjësimin publik mbi zbatimin dhe përfitimet e Planit të Rritjes për BP-në.

- ✓ O4.1. Shfaqja në rrjete sociale, video të animuara dhe seri podkastesh të sfidave të hasura gjatë zbatimit të Planit të Rritjes, duke përfshirë Agjendat e Reformave dhe Projektet e WBIF-t;
- ✓ O4.2. Prezantimi i ecurisë së reformave në BP me anë të serive të videove me përfaqësues të BE-së dhe institucioneve kombëtare;
- ✓ O4.3. Informimi i rregullt i mediave kombëtare mbi rezultatet e projektit dhe konsultimet mes qeverisë dhe OShC-ve.